

A K T – T H E M E L I M I
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
2R-Group

Ortaku i poshtëshënuar:

JETMIR UKPERAJ, atësia Rexhep, lindur më 13.06.1979 në Perollaj.
Kukës e banues në Tiranë, mbajtës i letërmjofimit nr. 031342292 me nr. personal
H95613119W,

madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ka rënë dakord të themelojë një **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**, duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil, në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në ligjin nr. 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (të ndryshuar), në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe në ligjet e dispozitat e tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 1

Emërtimi i shoqërisë

Shoqëria, e cila më poshtë në këtë akt do të quhet shkurtimisht “shoqëria”, do të marrë emërtimin “**2R-Group**” dhe është person juridik i të drejtës shqiptare.

NENI 2

Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

*zhvillimin e veprimtarisë minerare me punime sipërfaqësore dhe nëntokësore, shfrytëzim miniere e mineralesh, shfrytëzim gëlqerorësh;

*prodhim materialesh ndërtimi, tregtim me shumicë e pakicë materialesh ndërtimi, inerte rërë, çakull, mermer, etj.;

*ndërtime civile e ekonomike, industriale, turistike;

*ndërtime rrugore, hidroteknike, rikonstruksione eristrukturime nodinash e ndërtimesh civile, ndërtim rrjetesh inxhinierike, etj.;

*zhvillim veprimtarie pyjore, shfrytëzim, mbjellje pemësh, fidanesh; ndërtim e mirëmbajtje të mjediseve të gjelbëra (private, publike apo shtetërore), etj.;

*import –eksport materialesh industriale, automjetesh e makinerish ndërtimi si dhe pjesë ndërrimi për to.

Shoqëria, me vendim të organit administrativ të saj, mund të kryejë të gjitha aktet e duhura për realizimin e objektit të aktivitetit dhe kështu, ndër të tjera:

*Kryerjen e operacioneve tregtare dhe industriale, financiare e bankare, hipotekore dhe për pronat e paluajtshme;

*Ndërmarrjen e çdo lloj forme financimi me institutet kredituese, bankat, shoqëritë dhe privatët, duke dhënë garancitë e duhura reale;

*Marrjen pjesë në ndarjen e fitimit me shoqëri të tjera.

Për përbushjen e objektit të saj, shoqëria mund të shfrytëzojë të gjitha lehtësítë e parashikuara nga ligjet në fuqi dhe ligjet e pritshme.

Të gjitha shërbimet e lartpërmendura mund të zhvillohen si në tregun e brendshëm, ashtu dhe në tregun e jashtëm.



NENI 3

Selia

Shoqëria do ta ketë selinë në **Kodër e Madhe, Qyteti Krumë, Bashkia Has** (200 m nga rruga nationale), por me vendim të ortakëve mund të hapë degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë tij.

NENI 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do ta zhvillojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

NENI 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë. Ky kapital themeltar është i nënshkruar dhe i derdhur tëresisht me parë nga ortaku i vetëm i shoqërisë, zoti **JETMIR UKPERAJ**, i cili zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të rritet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së ortakëve; ky vendim është i vlefshëm në rast se ka votuar një shumicë që zotëron **tre të katërtat** e kapitalit themeltar.

Ortakët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve deri në vlerën e kontributit të çdo ortaku në kapitalin e shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të rritet duke pranuar ortakë të rinj, vetëm me miratimin e një shumice që zotëron **tre të katërtat** e kapitalit themeltar.

NENI 6

Administrimi

Sipas vendimit të ortakëve, shoqëria administrohet nga një administrator i vetëm.

Për ushtrimin e parë, administrator i shoqërisë do të jetë zoti **JETMIR UKPERAJ**, i cili deklaron se e pranon këtë detyrë dhe që do t'i ushtrojë funksionet e tij për një periudhë prej jo më shumë se 5 (pesë) vjet.

NENI 7

Viti finanziar

Viti finanziar i veprimtarisë ekonomike (duke përfshirë edhe këtë vit) mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti.

NENI 8

Për çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat që përbahen në Statutin e shoqërisë, Ligjet në fuqi si dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij akti themelimi, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata shqiptare.

Ky Akt Themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "2R-Group" hartohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe që kanë të gjitha të njëjtën vlerë. U lexua, u miratua dhe u nënshkrua nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

Sot në Tiranë, më 02.09.2015 (dy mijë e pesëmbëdhjetë) u redaktua, u lexua, u miratua dhe u nënshkrua në 4 (katër) kopje të njëjta (që kanë të gjitha të njëjtën vlerë) nga ortaku i vetëm ky akt themelimi që përmban 8 (tetë) nene dhe zë 3 (tri) faqe të daktilografuara

Ortakët themelues:

Ortaku i vetëm:

JETMIR UKPERAJ

JETMIR UKPERAJ

